



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Plani Vjetor i Auditimit

për sezonin e auditimit 2019/20

(1 shtator 2019 deri më 31 gusht 2020)

Prishtinë, gusht 2019

Tabela e përmbajtjes

1. Vizioni, Misioni dhe Vlerat	3
2. Hyrje	4
3. Llojet dhe Procesi i auditimit	5
4. Objektivat vjetore dhe Plani i auditimit	7
5. Buxheti dhe burimet njerëzore	11
6. Zbatimi	13

Shtojca 1. Subjektet dhe temat që do të auditohen

1. VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT

ZKA është institucion i pavarur në shërbim të qeverisjes së mirë dhe publikut. ZKA-ja është e përkushtuar në përmbushjen e mandatit të saj kushtetues e ligjor, me një vizion të qartë strategjik.

Vizioni

*“Institucion i besueshëm i auditimit,
që përmirëson qeverisjen në sektorin publik,
në interes të qytetarëve”*

Misioni

*“Përmes auditimeve cilësore
fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike
për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik
të burimeve kombëtare”*

Vlerat e ZKA-së

Pavarësia

Profesionalizmi

Integriteti

Transparenca

2. HYRJE

Zyra Kombëtare e Auditimit ("ZKA") si Institucion Suprem i Auditimit ("ISA") kryen auditimin e jashtëm të sektorit publik në Republikën e Kosovës. Mandati dhe detyrat e Auditorit të Përgjithshëm janë përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës ("Ligjin e ZKA-së").

ZKA auditon Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) të të gjitha organizatave buxhetore për të vlerësuar nëse ato ofrojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë dhe nëse paraja publike është shpenzuar për qëllimet për të cilat është aprovuar. ZKA poashtu kryen auditime të performancës me synim të përmirësimit të shërbimeve për qytetarët dhe ofrimin të tyre me kosto efektive.

Ky dokument paraqet Planin Vjetor të Auditimit, i cili përfshinë të gjitha aktivitetet audituese për sezonin auditues 2019/20. Sipas Ligjit të ZKA-së, ky dokument dorëzohet tek Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike (KMFP), për çdo vit, deri më 31 tetor.

Në hartimin e këtij dokumenti janë marrë në konsideratë: Plani strategjik i ZKA-së (2018-2021), përmbushja e obligimeve kushtetuese e ligjore për auditime të rregullsisë, mbulueshmëria sa më e gjerë me auditime të performancës bazuar në vlerësimin mbi rëndësinë, nivelin e rrezikut dhe aktualitetin e temave (çështjeve) të caktuara, përfshirja e një numri më të madh të ndërmarrjeve publike si dhe adresimi i kërkesave specifike të Kuvendit dhe të palëve të tjera të interesit, etj. Planifikimi i këtyre auditimeve është bërë duke pasur parasysh edhe burimet njerëzore dhe financiare që ka në disponim ZKA.

ZKA është e dedikuar që të ofrojë informacion cilësor mbi përdorimin e fondeve publike, të ndihmoj entitetet e audituara të përmirësojnë sistemet e tyre të menaxhimit financiar dhe kontrollit përmes rekomandimeve praktike dhe konstruktive, si dhe t'i shtojë vlerë veprimtarive të tyre operative dhe strategjike. Rezultatet e punës së ZKA-së kanë për qëllim të rrisin besueshmërinë në shpenzimin e fondeve publike.

Raportet e ZKA-së promovojnë llogaridhënie ndërmjet Kuvendit, Qeverisë dhe institucioneve publike në nivel institucional përmes shqyrtimit të raporteve individuale të auditimit nga Kuvendi, përkatësisht komisionet parlamentare, në veçanti Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike (KMFP), si dhe nga kuvendet komunale për auditimet e komunave dhe strukturat e qeverisjes korporative për auditimet e ndërmarrjeve publike. Në këtë mënyrë ZKA ndihmon në zhvillimin e qeverisjes së mirë dhe menaxhimit të financave publike si dhe jep kontributin e saj për zhvillimin e mëtejshëm të administratës publike.

Auditimet realizohen në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare të institucioneve supreme të auditimit ("SNISA"), duke u bazuar në vlerat univerzale të ISA-ve dhe të ZKA-së si, pavarësia, profesionalizmi, integriteti dhe transparenca. Të gjitha raportet e ZKA-së janë të qasshme për publikun dhe publikohen në faqen e internetit të ZKA-së.

3. LLOJET DHE PROCESI I AUDITIMEVE

3.1. Llojet e auditimeve

Në përputhje me mandatin dhe fushëveprimin e vet, gjatë sezonit 2019/20, ZKA do të kryej:

- **Auditime të rregullsisë** të organizatave buxhetore (bazuar në sistemin e parasë së gatshme) dhe të ndërmarrjeve publike (bazuar në sistemin aktual);
- **Auditime të performancës**; dhe
- **Auditime të teknologjisë informative**.

Auditimet e rregullsisë: përfshijnë auditimin e PFV-ve dhe llogarive kryesore të institucionit të audituar, me qëllim të vlerësimit nëse raportet janë të besueshme dhe llogaritë pasqyrojnë rezultatet e realizimit të buxhetit në mënyrë të drejtë; vlerësimin nëse menaxhmenti iu ka përmbajtur ligjeve dhe akteve nënligjore të zbatueshme dhe nëse fondet janë përdorur për qëllimet e synuara; dhe vlerësimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar, funksionet e auditimit të brendshëm dhe sistemet e kontrollit të brendshëm. Sipas Ligjit për ZKA, auditimet e rregullsisë¹ përfshijnë edhe auditime financiare edhe të pajtueshmërisë, prandaj në vazhdim po japim definicionet edhe për këto lloje të auditimeve.

- **Auditimi financiar.** Objektivi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisë nivelin e besimit tek përdoruesit e pasqyrave financiare. Kjo arrihet përmes dhënies së opinionit nga ana e auditorit nëse pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën raportuese në fuqi; si dhe të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si tërësi nuk pëmbajnë keqdeklarime materiale, raste mashtrimi ose gabime, si dhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve të tij/saj.
- **Auditimi i pajtueshmërisë.** Objektivi i auditimit të pajtueshmërisë është që të informojë përdoruesit nëse entitetet publike të audituara respektojnë vendimet e kuvendit, ligjet, aktet legislative, politikat, kodet dhe kushtet e vendosura.

Auditimet e rregullsisë kryhen për çdo vit. Procesi i auditimit fillon në shtator, ndërsa raportet e auditimit për OB-të individuale publikohen deri në fund të muajit qershor. Cikli i auditimeve përmbillet në fund të muajit gusht kur Raporti Vjetor i Auditimit (RVA) për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës (RFV/BK) dorëzohet në Kuvendin e Kosovës.

Auditimet e performancës: paraqesin një shqyrtim të pavarur, objektiv dhe të besueshëm nëse angazhimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat janë duke vepruar në përputhje me parimet e ekonomicitetit (minimizimi i kostove të burimeve), efikasitetit (përfitimi sa më shumë nga burimet në dispozicion) dhe efektivitetit (përmbushja e

¹ Sipas SNISA-ve të azhuruara nuk ekziston standard i veçantë për auditime të rregullsisë. SNISA-t i trajtojnë ndaras auditimet financiare nga ato të pajtueshmërisë.

objektivave të përcaktuara dhe rezultateve të synuara). Fushat, objektivat dhe koha e auditimit dhe e raportimit përcaktohen prej rastit në rast, duke u bazuar në rëndësinë, rrezikun, fushëveprimin e auditimit, kapacitetet ekzistuese si dhe kriteret tjera përkatëse.

Auditimi i performancës fokusohet në atë se si organizatat e sektorit publik i kanë përdorur burimet në dispozicion për t'i arritur objektivat e tyre. Për ekzaminimin e performancës së entitetit të audituar, ZKA ndjek një të tri qasjet:

- qasjen e orientuar në *rezultate*, e cila vlerëson nëse janë arritur objektivat e paracaktuara;
- qasjen e orientuar në *problem*, e cila verifikon dhe analizon shkaqet e problemit(ve); ose
- qasjen e orientuar në *sistem*, e cila ekzaminon funksionimin e sistemeve menaxhuese: ose një kombinim të të tri qasjeve.

Auditimet e teknologjisë informative (TI). Auditimi i TI-së definohet si ekzaminim dhe rishikim i sistemeve të teknologjisë informative (TI) dhe kontrollet e ndërlidhura me to, për të përfituar siguri ose për të identifikuar rreziqet lidhur me parimet e ligjshmërisë, efikasitetit, ekonomicitetit dhe efektivitetit të sistemeve të TI-së dhe kontrolleve lidhur me këto sisteme. Në terma të përgjithshëm, auditimet e TI-së shtrihen në auditimet financiare, në auditimet e pajtueshmërisë, në auditimet e performancës, por mund të realizohen edhe si auditime të veçanta.

3.2 Procesi i auditimeve

A. Procesi i auditimeve të rregullsisë - bazohet në metodologjinë e auditimit të përshkruar në Doracakun e Auditimeve të Rregullsisë dhe SNISA. Auditimi i rregullsisë kryhet nëpër disa hapa duke filluar nga:

- njohja e entitetit dhe analiza e rreziqeve;
- planifikimi i auditimit;
- ekzekutimi i auditimit;
- dhënia e konkluzioneve të auditimit;
- raportimi në Kuvend dhe informimi i opinionit publik (publikimi i raporteve); dhe
- përcjellja e adresimit të rekomandimeve të auditimit.

Procesi i auditimit të rregullsisë në ZKA monitorohet dhe rishikohet nga Departamenti për Metodologji dhe Kontrollin e Cilësisë në Auditim, i cili ka përgjegjësinë të siguroj menaxhmentin që auditimet janë kryer duke u bazuar në metodologjinë e aprovuar nga Auditori i Përgjithshëm dhe SNISA.

B. Procesi i auditimeve të performancës - bazohet në metodologjinë e auditimit të përshkruar në Doracakun e Auditimeve të Performancës dhe SNISA. Auditimi i performancës kryhet nëpër fazat në vijim:

Grafiku 1: Fazat e procesit të auditimit të performancës



Faza 1. Planifikimi. Përfshinë propozimin e temave për auditim dhe përgatitjen e memove parastudimore. Propozimet shqyrtohen përmes një procesi vlerësues lidhur me përshtatshmërinë dhe rëndësinë e temës për t'u audituar. Në këtë fazë poashtu, ekipet e auditimit bëjnë një hulumtim më të thellë rreth temës përkatëse, ku përcaktohen: problemi i auditimit, objektivat e auditimit, motivi i auditimit, fushëveprimi i auditimit, etj.

Faza 2. Ekzekutimi i punës në terren. Ekipet e auditimit pasi që të kenë përgatitur planin detaj të punës fillojnë me kryerjen e punëve audituese në terren dhe të hartojnë draft raportin e auditimit.

Faza 3. Raportimi. Ekipi auditues përfundon hartimin e raportit të auditimit, i cili duhet të jetë objektiv, gjithëpërfshirës, i qartë për lexuesin, etj. dhe pasi që raporti ka kaluar nëpër kontrollin e cilësisë dhe janë dhënë aprovimet e duhura, bën publikimin e tij.

Faza 4. Përcjellja e auditimit. Pasi të ketë kaluar një periudhë e përshtatshme kohe, ZKA mund të kryejë një vlerësim të progresit të entitetit të audituar në përgjigjet ndaj gjetjeve të auditimit dhe zbatimit të rekomandimeve dhe të raportojë për to përmes një auditimi përcjellës. Bazuar në standardet e auditimit si dhe në Doracakun për auditime të performancës, auditimet përcjellëse jo domosdoshmërisht kryhen për secilin auditim të kryer paraprakisht. Lidhur me auditimet përcjellëse vendoset në bazë të rëndësisë së temës.

4. OBJEKTIVAT VJETORE DHE PLANI I AUDITIMIT

Objektivat specifike të ZKA-së për sezonin auditues 2019/20 bazohen në Planin Strategjik të ZKA-së 2018-2021 me të cilin synohet: avancimi i mëtejme i metodologjisë së auditimit, përmirësimi i mëtejme i cilësisë dhe rritja e portofolios së auditimeve të performancës dhe të ndërmarrjeve publike dhe përzgjedhja e auditimeve relevante, bazuar në rrezik (për menaxhimin jo adekuat të fondeve publike). Për sezonën e auditimit 2019/20 janë përfshirë të gjitha auditimet e detyrueshme të rregullsisë të përcaktuara me nenin 18.3 të Ligjit të ZKA-së. Poashtu, është

përfshirë një numër më i madh i auditimeve të rregullsisë së ndërmarrjeve publike si dhe është rritur numri i auditimeve të performancës, krahasuar me sezonin e kaluar.

Në funksion të përmbushjes së objektivave strategjike, plani auditues për sezonin 2019/20 përfshinë kryerjen e 129 auditimeve, prej të cilave 120 auditime të rregullsisë dhe 9 auditime të performancës², siç janë paraqitur në Tabelën 1, në vijim.

Tabela 1: Numri dhe lloji i auditimeve të planifikuara për sezonin e auditimit 2019/2020

Llojet e auditimit	Numri i auditimeve
Auditime të rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë)	120
- Buxheti i Kosovës	1
- Institucione të nivelit qendror ³	58
- Komuna	38
- Ndërmarrje publike	14
- Projekte të financuara nga fondet e jashtme	9
Auditime të performancës⁴	9
- Auditime të performancës (prokurim & TI)	9
Gjithsej	129

Lista e të gjitha auditimeve është paraqitur në **Shtojcën 1** të këtij dokumenti.

Raportet individuale për auditimet e rregullsisë do të finalizohen deri më 30 Qershor 2020; Raporti Vjetor i Buxhetit të Kosovës do t'i dorëzohet Kuvendit të Kosovës jo më vonë se 31 gusht 2020. Ndërsa, auditimet e performancës dhe të projekteve do të publikohen sipas kalendarit kohor të përcaktuar dhe aprovuar nga Auditori i Përgjithshëm.

Angazhimi i burimeve njerëzore është bërë duke marrë parasysh: disponueshmërinë me burime njerëzore; kualifikimin dhe përvojën e stafit; madhësinë e buxhetit që auditohet, rrezikshmërinë dhe kompleksitetin e temës audituese; shfrytëzimin efikas të kohës, përcaktimin e afatit kohor për menaxhimin e auditimit të performancës dhe projekteve; si dhe përvojat e mësuara nga e kaluara.

² Përveç auditimeve të reja që janë paraparë me këtë plan, në proces të finalizimit janë 9 auditime të performances.

³ Auditimi i 22 Institucioneve të pavarura do të përkrahet nga një kompani private e auditimit.

⁴ Për temat e zgjedhura të auditimit të performances, së pari do të kryhen parastudimet dhe pastaj do të vendoset për auditimin e tyre.

4.1 Fokusi i auditimeve të rregullsisë

Për dallim nga sezoni i kaluar, në portofolion e auditimeve të rregullsisë është shtuar Fondi i Sigurimeve Shëndetësore si një organizatë e re buxhetore. Ndërsa, auditimi i 22 institucioneve të pavarura do të përkrahet nga një kompani private e auditimit, megjithatë opinioni i auditimit do të jepet nga Auditori i Përgjithshëm.

Është rritur poashtu për tri (3), numri i auditimeve të ndërmarrjeve publike, në krahasim me sezonin e kaluar, nga 11⁵ në 14. Në përzgjedhjen e tyre është marrë në konsideratë mbulueshmëria në tri nivele të organizimit, NP-të e nivelit qendror, rajonal dhe lokal, si dhe mbulueshmëria rajonale.⁶ Për herë të parë janë përfshirë në auditim të ZKA-së, tri (3) ndërmarrje publike, KRU Hidromorava, KRU Bifurkacioni dhe Ndërmarrja e Re Energjetike e Kosovës.

Për sezonin auditues 2019/20, ZKA ka planifikuar auditimin e rregullsisë (financiar dhe të pajtueshmërisë) së nëntë (9) projekteve që financohen nga Banka Botërore dhe Agjencioni Suedez për Zhvillim (SIDA).

4.2 Fokusi i auditimeve të performancës

Procesi i përzgjedhjes së temave të auditimeve të performancës ka synuar maksimizimin e ndikimit që pritët nga auditimi, duke pasur parasysh kapacitetet e auditimit. Në planin auditues 2019/2020 janë përfshirë tema nga fusha të rëndësishme, si: ekonomia, shëndetësia, arsimi, investimet publike (prokurimi publik), mjedisi dhe teknologjia informative. Për të përcaktuar planin vjetor të auditimeve të performancës, janë kërkuar propozime për temat nga të gjithë auditorët e ZKA-së (përfshirë ata të rregullsisë) dhe pastaj temat e propozuara janë rishikuar fillimisht nga udhëheqësit e departamenteve të auditimit dhe më pas edhe nga Ndihmës Auditori i Përgjithshëm për auditime të performancës. Për të siguruar relevancën e temave të auditimit për qytetarët dhe me qëllim të marrjes së propozimeve të reja për temat e auditimit, ZKA ka zhvilluar konsultime edhe me organizatat e shoqërisë civile.

Në vijim janë dhënë disa informata për fushat e përzgjedhura:

Zhvillimi ekonomik dhe mirëqenia sociale.- Investimi i duhur i parasë publike ndikon drejtpërdrejt në rritjen e mirëqenies së qytetarëve dhe zhvillimin ekonomik në përgjithësi. Në vitet e fundit, ekonomia është nxitur nga investimet publike në infrastrukturë dhe në konsum privat, ky i fundit është financuar nga remitancat e konsiderueshme nga jashtë dhe rritja e pagave dhe kredive. Edhe pse në vitin 2017, kishte rritje të jashtëzakonshme (18.8%) të eksporteve, trendi u ngadalësua në 13.9% në vitin 2018. BPV-ja për frymë në Kosovë vazhdon të mbetet më e ulta në rajon, në vitin

⁵ Në planin e vitit të kaluar ishin përfshirë 12 NP, në mesin e të cilave edhe Lotaria e Kosovës, auditimi i së cilës është ndërprerë, pasi gjatë procesit të auditimit, Kuvendi i Kosovës ka nxjerrë ligj të veçantë për mbylljen e të gjitha kompanive që merren me lojëra të fatit.

⁶ Përzgjedhja e NP-ve është diktuar edhe nga gjendja e kontraktimeve për shërbimet e auditimit të jashtëm, pasi që një numër i NP-ve kanë kontrata për auditimin e PFV-ve të tyre edhe për vitin 2019.

2018 ishte 3.9%. Viteve të fundit, ZKA ka kryer auditimin e subvencioneve në zhvillimin e bujqësisë si një sektor i rëndësishëm në zhvillimin ekonomik, politikat e punësimit në sektorin publik si dhe është në proces të finalizimit të auditimeve çmimet e tarifave të shërbimeve publike dhe korniza afatmesme e shpenzimeve. Për shkak të rëndësisë që ka promovimi dhe mbështetja e investimeve të huaja për zhvillimin ekonomik si dhe rënies së vazhdueshme të investimeve të huaja gjatë viteve të fundit, ZKA në planin e auditimit për 2019/2020 do ta përfshij këtë fushë në planin auditues. Fokusi i këtij auditimi do të jetë vlerësimi i efektivitetit të politikave qeveritare në tërheqjen e investimeve të huaja direkte.

Shëndetësia. Sigurimi i qasjes së plotë në kujdes shëndetësor dhe në barna në të gjitha nivelet dhe për të gjithë qytetarët është e drejtë e garantuar me Kushtetutë. Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2018, ka potencuar disa vështirësi lidhur me sektorin shëndetësor. Shpenzimet e ulëta publike në shëndetësi mbesin brengosëse. Sipas raportit u vlerësua që vetëm 40% të nevojave të përgjithshme vjetore për shëndetësi publike mbulohen. Fondet e alokuara kryesisht shpenzohen për të mbuluar kosto fikse (rreth 68%), duke lënë vetëm rreth 32% për kosto direkte të pacientëve, lidhur me diagnostikimin, trajtimin dhe parandalimin. Marrë parasysh raportet e fundit të ZKA-së sektori i shëndetësisë vazhdon të përballet me vështirësi në ofrimin e duhur të kujdesit shëndetësor ndaj qytetarëve. Viteve të fundit, ZKA ka kryer auditimin e “Sistemit Informativ Shëndetësor”, “Listën esenciale të barnave”, auditimin përcjellës “Menaxhimi i pajisjeve mjekësore”, si dhe është në proces të finalizimit të auditimeve “Siguria në ushqim” dhe “Siguria në trafikun rrugor”. Në vitin 2016, është bërë auditimi i “Programit të trajtimit të pacientëve jashtë vendit” dhe për arsye se, kostoja e këtij programi është e lartë (rreth 11 milion euro në vit) si dhe duke pasur parasysh rëndësinë e tij për mirëqenien dhe shëndetin e qytetarëve, auditimi i këtij Programi do të jetë pjesë e planit auditues 2019/2020. Fokusi i këtij auditimi do të jetë vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve të auditimit paraprak me objektivë shtesë nëse programi ka arritur efektin e synuar tek pacientët.

Mjedisi. Sipas praktikave të mira evropiane një sistem i qëndrueshëm, efikas dhe i integruar për mbrojtjen e mjedisit ekziston kur autoritetet publike bashkëpunojnë dhe koordinojnë punët mes veti për hartimin dhe zbatimin e çdo aktiviteti apo mase me qëllim të mbrojtjes së mjedisit. Për shkak të rëndësisë së madhe që ka mjedisi, ZKA ka audituar segmente të rëndësishme të tij, siç janë “Cilësia e ajrit” dhe “Kontrolli dhe monitorimi i cilësisë së derivateve të naftës” (si një ndër ndotësit potencial të mjedisit). Sipas informatave në media dhe raporteve të organizatave të ndryshme, si pasojë e operimeve të shumë gurëthyesve në Kosovë po dëmtohen me të madhe lumenjtë, malet dhe resurset e tjera natyrore. Po ashtu, ka indikacione për ndikime negative financiare për buxhetin e shtetit. Andaj, auditimi i sistemit të licencimit të gurëthyesve dhe mbrojtja e ambientit nga kjo veprimtari do të jetë pjesë e planit auditues 2019/2020. Fokusi i këtij auditimi do të jetë vlerësimi nëse sistemi ekzistues i licencimit të gurëthyesve është menaxhuar si duhet dhe janë ndërmarrë masa për të siguruar mbrojtjen e ambientit.

Arsimi. Kosova karakterizohet me popullsinë më të re në Evropë, e cila vlerësohet si potencial i rëndësishëm për zhvillimin e kapitalit njerëzor. Megjithatë, mungesa e vendeve të reja të punës dhe mospërputhja e aftësive të të diplomuarve me nevojat e tregut të punës përbëjnë disa nga sfidat kryesore me të cilat përballen të rinjtë kosovarë. Viteve të fundit, ZKA ka kryer auditimin e procesit të rishikimit të teksteve shkollore dhe menaxhimin e teksteve shkollore. Për shkak të rëndësisë që ka ndërlidhja e aftësimin profesional me tregun e punës, kjo temë do të jetë pjesë e planit auditues 2019/2020. Fokusi i këtij auditimi do të jetë vlerësimi nëse institucionet përgjegjëse kanë zhvilluar një sistem i cili mundëson aftësimin profesional në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Teknologjia Informative. Zhvillimi i vazhdueshëm i Teknologjisë Informative dhe Komunikimit ka bërë të mundur ruajtjen, procesimin dhe ofrimin e informacioneve në mënyrë elektronike. Me rritjen e aplikimit të teknologjisë (sistemeve) të informacionit dhe komunikimit, rritet edhe rëndësia (nevoja) e auditimeve të TI-së. Auditimet e fundit të TI-së të kryera nga ZKA kanë treguar se investimet e qeverisë në këtë fushë janë bërë pa ndonjë analizë të mirëfilltë dhe si të tilla kanë rezultuar jo funksionale. Organizatat buxhetore kanë mungesë të theksuar të strategjisë së Teknologjisë Informative, politikave dhe procedurave si dhe strukturë jo të përshtatshme organizative të departamentit të TI-së. Mungesa e tyre rrezikon arritjen e objektivave të organizatës buxhetore si dhe mund të rrezikoj sigurinë e informacionit. Për shkak se një pjesë e konsiderueshme e të hyrave të përgjithshme buxhetore menaxhohen nga Administrata Tatimore e Kosovës, sistemi për arkëtimin e tatimeve qendrore SIGTAS do të jetë pjesë e planit auditues 2019/2020. Fokusi i këtij auditimit do të jetë vlerësimi i sigurisë së qasjeve logjike për regjistrime, ndryshimeve dhe fshirje në sistem, kontrolleve logjike të modulit për llogaritjen e interesave si dhe ekzistenca e gjurmëve të auditimit. Më tutje, Agjencia e Statistikave e Kosovës është burim i vetëm i informacionit dhe statistikave për fusha të ndryshme në vend të cilat gjenerohen përmes sistemit të TI edhe kjo temë do të jetë pjesë e planit auditues. Fokus i këtij auditimi do të jenë kontrollet e përgjithshëm të TI që përfshijnë mjedisin e përgjithshëm në të cilin sistemet e TI janë zhvilluar, operuar, menaxhuar dhe mirëmbajtur.

Prokurimi publik. Në vitin 2018, institucionet publike përmes procedurave të prokurimit publik kanë kontraktuar 30% të buxhetit të Kosovës, duke nënshkruar 12,412 kontrata (përfshirë anekse kontratat) në vlerë të përgjithshme prej 632 milion €. Përkundër avancimeve në sistem, auditimi i vitit 2018 ka identifikuar se aktivitetet e prokurimit vazhdojnë të përcjellën me mangësi duke filluar nga planifikimi i prokurimit, zhvillimi i procedurave të prokurimit, deri te menaxhimi i kontratave. Gjatë vitit 2018, ishin nënshkruar 499 kontrata jashtë planit të prokurimit, prej tyre pjesën më të madhe e përbëjnë komunat me afro 72%, institucionet qendrore me mbi 15%, ndërsa institucionet e pavarura me afër 13%. Viteve të fundit, ZKA ka kryer auditimin e prokurimeve të centralizuara, procedurat me negociim pa publikim, tenderët në lloje dhe është në proces të finalizimit të auditimit menaxhimi i kontratave të ndërtimit. Raporti i auditimit të prokurimeve të centralizuara

(pjesa e parë), e publikuar në vitin 2018 ka identifikuar rreziqet e mundshme për mos arritjen e vlerës për para. Fokusi i këtij auditimi do të jetë vlerësimi nëse rreziqet e identifikuar në pjesën e parë të auditimit janë materializuar. Më tutje, për shkak të kostos së lartë që ka investimi në rrugë (për vitin 2018, ishin shpenzuar afro 63 milion €) dhe ndikimit që rrugët kanë në përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve kjo temë është vendosur në planin auditues 2019/2020. Fokusi i këtij auditimi do të jetë ekonomia apo krahasimi i çmimeve për projekte/kontrata që kanë specifika të njëjta dhe të krahasueshme dhe do të përfshijë krahasimin e rrugëve të prokuruar nga qeveria qendrore me ato lokale.

Auditimet përcjellëse për vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit të performances:

Procesi i auditimit nuk përfundon me nxjerrjen e raportit të auditimit apo me përgatitjen e planit të veprimit për adresim të rekomandimeve nga subjekti i audituar, pasi që këto veprime nuk ofrojnë siguri që këto rekomandime do të zbatohen. Për këtë qëllim, është e nevojshme të bëhet monitorimi i zbatimit të rekomandimeve në baza të rregullta. Përcjellja e rekomandimeve të auditimit të performancës rrit efektivitetin e aktiviteteve të institucionit suprem të auditimit, përfshirë ndikimin e auditimit, si dhe rritjen e llogaridhënies ndaj publikut. ZKA për sezonin e auditimit 2019/2020 do të kryej vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të auditimit të performances të dhëna në raportet e auditimit të publikuara në vitin 2017.

4.3 Kontrolli dhe sigurimi i cilësisë

Cilësia në auditim është kërkesë ligjore dhe e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit për Institucionet Supreme të Auditimit (SNISA). Puna e personelit të angazhuar në kuadër të Departamentit për Metodologji dhe Kontroll të Cilësisë së Auditimit fokusohet në aktivitete të caktuara për krijimin e kushteve për kryerjen e punëve audituese me cilësinë e duhur si dhe në zbatimin e mekanizmave të përcaktuar për kontrollin e cilësisë në gjithë procesin e auditimit.

Aktivitetet themelore gjatë këtij sezoni do të fokusohen në:

- hartimin dhe përditësimin e doracakëve të auditimit, letrave të punës, përcjelljen dhe prezantimin e ndyshimeve në SNISA, ofrimin e mbështetjes profesionale për auditorët, identifikimin e nevojave për trajnime dhe ofrimin e tyre. Këto aktivitete do të kryhen me përkrahjen profesionale të institucionit suprem të auditimit të Polonisë, cili implementon projektin e binjakëzimit të financuar nga Bashkimi Evropian;
- rishikimin e procesit të auditimit në të gjitha fazat dhe zbatimin e kontrollit të cilësisë në auditim sipas një plani të veçantë të punës; dhe
- analizimin e të dhënave të caktuara dhe përpunimin e tyre për qëllime të auditimit.

5. BUXHETI DHE BURIMET NJERËZORE

5.1. Buxheti

ZKA financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës i cili miratohet nga Kuvendi i Kosovës, sipas procedurës së përcaktuar me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Për vitin 2019, buxheti i miratuar i ZKA-së është rreth 3,4 milion €. Krahasuar me vitin paraprak, buxheti për vitin 2019 shënon një rritje prej 18%, e cila rezulton nga rritja e fondit në kategoritë ekonomike: Mallra dhe shërbime, Investime kapitale, si dhe Paga dhe mëditje. Ka një rritje jo të ndieshme në kategorinë e Mallrave dhe shërbimeve (rreth 10%), përkatësisht për shpenzimet e përgjithshme operative, për shkak të përfshirjes më të madhe në auditim të ndërmarrjeve publike dhe të auditimeve të performancës. Kurse rritje më të theksuar të buxhetit ka te Investimet kapitale (rreth 89%), për shkak të përfshirjes së projektit për zhvillimin e softuerit për auditim, në shumën prej 400,000€, si dhe te kategoria e Pagave (rreth 4.5%) për shkak të rritjes së numrit të punonjësve, për pesë (5) më shumë krahasuar me vitin 2018 dhe të përfshirjes në buxhet të rritjes ekonomike prej 4% e cila ka reflektuar në rritjen përkatëse të pagave.

Me këtë buxhet mundësohet kryerja e auditimeve të rregullsisë për të gjitha organizatat buxhetore, për auditimin e një numri të kufizuar të ndërmarrjeve publike dhe kryerjen e auditimeve të caktuara të performancës.

Me ndarjen e miratuar buxhetore për vitin 2019 dhe burimet njerëzore të ZKA-së, të shtuara për pesë (5) punonjës, mundësohet që për sezonin e auditimit 2019/20 të përfshihen në Planin vjetor të auditimit disa auditime më shumë. Megjithatë, realizimi i objektivave strategjike të ZKA-së për përfshirje më të theksuar në auditimin e rregullsisë të ndërmarrjeve publike dhe për rritjen e portofolios së auditimeve të performancës kërkon më shumë burime financiare dhe njerëzore. Konform me këto nevoja, ZKA ka planifikuar dhe proceduar kërkesën buxhetore për vitin 2020.

ZKA ka marrëveshje bashkëpunimi me disa organizata homologe dhe partnerë ndërkombëtar. Aktivitetet e parapara në kuadër të këtij bashkëpunimi do të financohen kryesisht nga partnerët e ZKA-së.

5.2 Burimet njerëzore dhe trajnimet

Aktualisht ZKA i ka të punësuar 167 punonjës, ndërsa i ka të miratuara me buxhetin vjetor 172 vende pune. Prej tyre 141 janë të angazhuar drejtpërdrejt në auditim, kurse pjesa tjetër në shërbimet tjera menaxheriale, profesionale, administrative dhe mbështetëse. Strukura kualifikuese e punonjësve auditues është e mirë dhe në proces të përmirësimit të vazhdueshëm.

Për të arritur qëllimet strategjike, ZKA është duke investuar në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të burimeve njerëzore. Punonjësve auditues do t'iu mundësohet vijimi i trajnimeve dhe arritja e normativit të përcaktuar me SNISA për arsimin e vazhdueshëm profesional, si një

nga faktorët themelor për kryerjen e auditimeve me kompetencë, cilësi dhe sipas kërkesave të SNISA-ve.

Në ZKA, sipas planit vjetor të trajnimeve, mbahen trajnime të rregullta, kryesisht në muajt korrik dhe janar kur auditorët kanë më pak angazhime në procesin e auditimit. Trajnimet mbahen nga ekspertët e ZKA-së dhe ata të jashtëm, pastaj një numër i konsiderueshëm i punonjësve përfitojnë trajnime nga partnerët e jashtëm si, Zyra Kombëtare e Auditimit e Suedisë dhe ajo e Polonisë, Gjykata Evropiane e Auditorëve, Banka Botërore, USAID-i, etj.

Me organizimin e trajnimeve do të vazhdohet edhe për sezonin e auditimit 2019/20. ZKA harton planin vjetor të trajnimeve që përfshinë trajnime nga ekspertët e ZKA-së dhe ekspertë të jashtëm. Përmbajtja e trajnimeve dhe mënyra e organizimit të tyre do të adaptohet në funksion të zbatimit të objektivave të përcaktuara strategjike dhe të menaxhimit të performancës individuale. ZKA është në proces të shqyrtimit të kriterëve dhe përcaktimit të standardeve për edukimin e vazhdueshëm profesional të stafit auditues.

6. ZBATIMI

Plani do të zbatohet nga 1 shtatori 2019 deri më 31 gusht 2020. Për zbatimin e aktiviteteve të parapara me këtë dokument ZKA do të përgatis plane të veçanta veprimi, sipas fushave dhe projekteve të caktuara.

Prishtinë, gusht 2019

Besnik Osmani
Auditor i Përgjithshëm

Shtojca 1. Subjektet dhe temat që do të auditohen

Shtojca 1. Subjektet dhe temat që do të auditohen

A. AUDITIMET E RREGULLSISË

Tabela 2: Institucione të nivelit qendror [1 + 57 = 58]

	Entitetet nën auditim	Buxheti 2019
1	Auditimi i Raportit Vjetor të Buxhetit të Republikës së Kosovës	2,378,231,797
2	Kuvendi i Kosovës	11,219,282
3	Zyra e Presidentit	4,608,189
4	Zyra e Kryeministrit	18,554,041
5	Ministria e Financave	47,140,629
6	Administrata Tatimore e Kosovës	14,296,096
7	Dogana e Kosovës	11,681,870
8	Ministria e Administrimit Publik	28,864,620
9	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	58,977,962
10	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	12,677,391
11	Ministria e Infrastrukturës	301,487,752
12	Ministria e Shëndetësisë	39,863,809
13	Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës	121,171,263
14	Fondi i Sigurimeve Shëndetësore	8,697,583
15	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	44,733,726
16	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	73,238,320
17	Univerziteti i Prishtinës	34,785,502
18	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	466,661,828
19	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	54,885,402
20	Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit	7,543,153
21	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	12,201,508
22	Ministria e Zhvillimit Ekonomik	40,278,861
23	Ministria e Punëve të Brendshme	124,158,193
24	Ministria e Drejtësisë	23,533,261
25	Ministria e Punëve të Jashtme	32,218,816
26	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës	58,688,060
27	Ministria për Integrimet Evropiane	2,589,082
28	Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike	2,435,747
29	Ministria e Zhvillimit Rajonal	5,979,529
30	Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë	11,167,520
31	Keshilli Prokurorioral i Kosovës	14,170,065
32	Komsioni i Pavarur i Minerave dhe Mineraleve	1,409,356
33	Këshilli Gjygjësor i Kosovës	29,404,466
34	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik*	796,876
35	Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës*	1,356,427

36	Autoriteti i Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare*	1,879,408
37	Agjencioni Kundër-Korrupsion*	584,643
38	Zyra Rregullatorit për Energji*	836,789
39	Organi Shqyrtues i Prokurimit*	390,719
40	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas*	406,135
41	Gjykata Kushtetuese e Kosovës*	1,868,447
42	Autoriteti Kosovar i Konkurrencës*	353,707
43	Këshilli i Kosovës për Trashigimi Kulturore*	221,515
44	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa*	218,588
45	Këshilli i Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës*	393,576
46	Autoriteti Rregullativ i Shërbimeve të Ujit*	392,371
47	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave*	423,924
48	Autoriteti i Aviacionit Civil*	1,000,236
49	Komisioni i Pavarur i Mediave*	1,137,474
50	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	5,997,490
51	Institucioni i Avokatit të Popullit*	1,373,754
52	Akademia e Drejtësisë*	1,433,309
53	Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës*	2,990,706
54	Agjensioni Shtetëror për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*	365,203
55	Agjencioni për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale*	6,933,973
56	Fondi i Privatizimit	-
57	Agjencioni Kosovar i Privatizimit	8,276,049
58	Agjencioni për Shërbimet e Navigimit Ajror*	7,130,150

*Institucionet e Pavarura, auditimi i së cilave do të përkrahet nga kompania private e auditimit.

Tabela 3: Komuna [38]

	Entitetet nën auditim	Buxheti 2019
1	Prishtinë	87,733,825
2	Obiliq	12,168,718
3	Podujevë	22,032,619
4	Fushë Kosovë	11,097,733
5	Mitrovica e Jugut	19,728,815
6	Graçanicë	7,439,178
7	Mitrovica e Veriut	6,042,381
8	Zubin Potok	2,569,693
9	Zveçan	2,501,643
10	Prizren	4,759,4260
11	Mamusha	2,073,560
12	Malishevë	14,392,380
13	Rahovec	13,760,891
14	Lipjan	15,896,971

15	Shtime	7,257,985
16	Suharekë	16,260,041
17	Shtërpçë	3,794,171
18	Kllokot	1,241,812
19	Gjilan	25,544,787
20	Viti	11,399,551
21	Novobërdë	2,781,639
22	Ferizaj	30,934,946
23	Klinë	10,138,948
24	Pejë	26,598,410
25	Istog	10,678,115
26	Glllogoc	15,171,602
27	Skenderaj	13,404,283
28	Vushtrri	19,119,355
29	Gjakovë	24,785,173
30	Deçan	8,951,356
31	Dragash	8,404,652
32	Junik	1,784,765
33	Kamenicë	9,359,447
34	Leposaviq	4,642,073
35	Partesh	1,243,873
36	Ranillug	1,825,748
37	Kaçanik	8,381,634
38	Hani i Elezit	2,915,921

Tabela 4: Ndërmarrje publike [13]

	Entitetet nën auditim	Buxheti 2019
1	KMDK	2,635,629
2	Trainkos	4,228,810
3	Hortikultura Prishtine	1,383,803
4	KRU Hidromorava	2,452,182
5	KRM Uniteti	1,701,900
6	KRU Hidroregjioni Jugor	5,300,742
7	Stacioni i Autobusëve – Prishtinë	1,038,341
8	KRU Prishtina	17,790,000
9	KR e Ujitjes Drini i Bardhë	156,452
10	KRM Pastrimi - Prishtine	7,325,000
11	Vala - Telekom	70,541,000
12	Posta e Kosoves	13,749,000
13	KRU Bifurkacioni sh.a Ferizaj	2,752,763
14	Ndërmarrja e Re Energjetike e Kosovës	115,000

Tabela 5: Projekte që financohen nga huamarrja shtetërore dhe nga donatorët [9]

	Entitetet nën auditim	Buxheti
1	Projekti për përmirësimin e sistemit edukativ në Kosovë (MASHT)	2,397,000
2	Konkurrueshmëria dhe gatishmëria për eksport (MTI)	2,266,513
3	Efiçienca e Energjisë së ripërtrishme (MZHE)	3,873,201
4	Zhvillimi Rural dhe Agrobujqësor (MBPZHR)	3,633,000
5	Forcimi i Planifikimit dhe Ekzekutimit në Para të Gatshme	200,000
6	Programi Mjedisor i Kosovës – PMK 2016-2020 (MMPH)	629,526
7	Ekonomia Digjitale në Kosovë	2,300,000
8	Procesi i Zhvillimit të Politikbërjes në Kosovë (ZKM)	276,300
9	Projekti për Shëndetësinë e Kosovës (MSH)	4,351,103

B. AUDITIMET E PERFORMANCËS

Tabela 6: Temat e auditimeve të performancës [9]

	Temat nën auditim
1	Ndërlidhja e aftësimit profesional me tregun e punës
2	Auditim përcjellës: Programi I trajtimit jashtë institucioneve shëndetësore publike si dhe arritja e rezultateve
3	Efektiviteti i politikave qeveritare për tërheqjen e Investimeve të Huaja Direkte
4	Sistemi i licencimit të gurëthyesve dhe mbrojtja e ambientit nga kjo veprimtari
5	Prokurimet e centralizuara (pjesa e dytë)
6	Vlera për para në ndërtimin e rrugëve rajonale dhe lokale
7	Vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve të auditimit të performancës për vitin 2017
Auditime të teknologjisë informative	
8	ATK-SIGTAS Moduli i arkëtimit të borxheve
9	Teknologjia Informative në Agjencinë e Statistikave të Kosovës



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

<http://www.zka-rks.org>